



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 7470 Prot

Shkodër, më 1.6.2020

VENDIM

Nr. 120, datë 1.6.2020

PËR

SHPALLJEN E REZULTATEVE TË THIRRJES SË TRETË PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME TË PARAQITURA NGA ORGANIZATA E SHOQËRISË CIVILE NË KUADËR TË PROGRAMIT RELOAD, NË BASHKINË SHKODËR PËR VITIN 2020

Në mbështetje të Ligji nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar, të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë nr 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit plotësues nr 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, VKB nr 26, datë 30.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020” dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër”, VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për “Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër” si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”, VKM 540, datë 21/12/1992, "Për krijimin e Këshillave të Kulturës dhe shpërblimin e tyre” të ndryshuar me VKM 121, datë 25.02.2005, si dhe të Udhëzimit Nr 1, datë 24/05/2005 të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko –kulturore”, VKB nr.27 datë 01.06.2016 “Për ngritjen e Këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër” i ndryshuar, Miratimin e shpalljes së Thirrjes së III-të publike për organizatat e shoqërisë civile nr. 3814/1, datë 21.01.2020 dhe mbështetur në raportin përmbledhës dt. 29.05.2020.

VENDOSA:

1. Të miratoj raportin përmbledhës, zhvillimin e procedurës dhe klasifikimin përfundimtar të projekteve.
2. Të shpallë fituese projekt propozimet e organizatave të shoqërisë civile, si më poshtë:

Nr.	Emri i OShC	Titulli i projektit	Pikët e fituara	Vlera e projektit propozuar në lek
1	Shoqata Rrok Jakaj	Shkodra Jazz Festival	81	1,900,000
2	The Door	Shkodra e traditës dhe kulturës	78	1,100,000
3	Shoqata e Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë	Shkodra në panairot e Arti Zanatit	69	1,114,500
4	Shoqata Rrok Jakaj	Ndërmendje	69	1,080,000
5	Green Centre Albania	Mbështetje ekonomike ose e agrobizneseve me qëllim fokusimin drejt agro dhe ekoturizmit në Nj.A Berdicë, Ana e Malit, Dajç, Guri i Zi, Shosh, Pult, Rrethina, Postribe.	68	1,436,000

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Biznesit, Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

